[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 8/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
- c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojces nr 9/*Kriteret e Pergjithshme te kualifikimit*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron mesatare vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2017-2018,2019), e cila duhet të jetë, minimalisht, 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.
- 2.2.2 Kopje të bilancit për vitin 2018 të dorëzuara dhe pranuar nga administrata tatimore shoqëruar me raportet e ekspertit kontabël në përputhje me nenin 41, gërma c) e Ligjit nr. 10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.
- 2.2.3 Operatori ekonomik duhet të provojë se ka shlyer detyrimet vendore për vitin 2019. Për të provuar këtë duhet të paraqesë një vërtetim të leshuar nga organet e njësisë së qeverisjes vendore.
- 2.2.4 Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2.3 Kapaciteti teknik:

Tek Objekti i Ekstraktit të QKR të jete percaktuar veprimtaria; Tregtim me shumice e pakice të artikujve ushqimorë dhe fruta-perime.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, minimalisht, në vlerën prej 40 % të vlerës së fondit limit.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e leshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate;

ose

- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes ku shënohen mallrat, shumat dhe vlerat.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:

- License kategoria: **II.1.A. 1 “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”**, të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Për të plotësuar këtë kriter për kualifikim, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencën kategoria II.1A.1 – “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz”, në emër të tij, pasi licenca duhet t’i përkasë operatorit ekonomik të interesuar të ofertojë për procedurë e prokurimit të shpallur nga autoriteti kontraktor.

- License të leshuar nga QKL me kod II.1.B . (Shitje me shumice e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz).

Theksojmë se, gjatë vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktor do të mbajë në konsideratë faktin se, nuk lejohet përdorimi i licencës të një operatori tjetër ekonomik.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrata duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme si më poshtë:

- Çertifikate **ISO 9001:2015** **”Per menaxhimin e cilesise”** objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.e vlefshme e leshuar minimalisht para nje muaji nga data e hapjes se tenderit.
- Çertifikate **EN-ISO 22000 :2005** **”Per sistemin e Menaxhimit te Sigurise Ushqimore”** objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.e vlefshme e leshuar minimalisht para nje muaji nga data e hapjes se tenderit.
- Çertifikate **ISO 14001 :2015** **”Per sistemin e Menaxhimit te Mjediset”** objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.e vlefshme e leshuar minimalisht para nje muaji nga data e hapjes se tenderit.
- Çertifikate **ISO BS OHSAS 18001 :2007** **”Per sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune”** objekt i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.e vlefshme e leshuar minimalisht para nje muaji nga data e hapjes se tenderit.
- Çertifikate **UNI 10854 :1999 H.A.C.C.P** **”Per sistemin e Menaxhimit te Autokontrollit”** objekt i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.e vlefshme e leshuar minimalisht para nje muaji nga data e hapjes se tenderit.

Shënim: Çertifikatat e mesiperme/ekuivalente duhet të jenë të leshuar nga Institucione të certifikuar/akredituar në Shqipëri ose tek ato ndërkombëtare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këto certifikata në përputhje me shërbimet që ka marrë persiper në marrëveshjen e bashkëpunimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument për pronësi ose përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara, **Njesi tregtare ushqimore ose ambiente për magazinimin e artikujve të tjere ushqimore**, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambientet duhet të plotësojnë kushtet Higjieno-Sanitare dhe të jenë të pajisur me çertifikate pronësie (original ose kopje e noterizuar) dhe i pajisur me **Akt-Miratim higjieno-sanitare**, të leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetsor (ISHSH).

2.3.5 OE duhet të ketë në pronësi, ose në përdorim ambiente të pershtatshme, për magazinimin e mallrave ushqimore me origjinë shtazore, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës,

Dokumentat Standarde të Tenderit

ambientet e kerkuara duhet te plotesojne kushtet higjeno-sanitare.

Per produktet me origjine shtazore, operatori ekonomik duhet te disponoje brenda ambienteve te tij dhome frigoriferike per magazinimin e produkteve shtazore, vertetuar kjo me fature tatimore te shitjes

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te disponoje nje pike shitje per fruta perime dhe zarzavate ose te paraqese kontrate furnizimi per fruta-perime dhe zarzavate te fresketa, brenda qytetit Lezhe, shoqeruar me QKB e furnizuesit ku te jete specifikuar furnizimi ne vijimesi e te vazhdueshem per te gjithë periudhen e marreveshjes kuader.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje nje pike shitje ose te paraqese kontrate furnizimi per buke, brenda qytetit Lezhe, ku te jete specifikuar furnizimi ne vijimesi dhe te vazhdueshem per te gjithë periudhen e marreveshjes kuader, shoqeruar me ekstraktin tregtar te furnizuesit.

2.3.8 Operatoret ekonomik (OE) duhet te disponojne 1 (nje) automjet te peshtatshem ATV (frigorifer) per transportimin e mallrave dhe 1 (nje) automjet te pershtatshem ATP (jo frigorifer) per transportimin e mallrave objekt prokurimi dhe zbatimin e kontrates.

a).Per kete qellim operatoret duhet te kene ne pronesi ose me qera mjet per transportimin e ushqimeve sipas llojit te tyre. Ata duhet te paraqesin deshmi per 2 (dy) mjete te tilla, gjate periudhes se zbatimit te kontrates.

b).Ne funksion te zbatimit te kontrates, kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Gjendja Juridike
1.	Automjet ATV (frigorifer) per transportimin e produkteve ushqimor	Cope	1	Pronësi ose me qera
	Automjet ATV (jo frigorifer) per transportimin e produkteve ushqimor	Cope	1	Pronësi ose me qera

Per te deshmuar kete, operatoret ekonomike duhet te paraqesin dhe dokumentat e meposhtem:

- Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publik, nese jane ne pronesi, duhet te paraqitet dokumentacioni qe verteton regjistrimin e mjetit si: Leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, si dhe polica e sigurimit vjetor te vlefshem ne daten e hapjes se ofertave.
- Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publik, nese jane me qera, duhet te paraqitet dokumentacioni qe verteton regjistrimin e mjetit si: Kontrata noteriale e qerese, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor te vlefshem ne daten e hapjes se ofertave.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar minimalisht **8 (tete)** punonjes per periudhen **Janar 2020-Maj 2020**, (kjo per arsye se operatori ekonomik duhet te marre persiper shperndarjen ditore te ushqimeve ne kater pika te ndryshme), e vertetuar kjo me vertetimin e leshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve.

- 2.3.10** Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesë vetedeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU-se, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.
- 2.3.11** Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin një deklaratë nga administratori i shoqërisë për skadencën e produkteve ushqimore, e cila duhet të jetë nga 6 muaj - 1 vit nga momenti i levrimit të mallit si dhe furnizimin e plotë për periudhën e zbatimit të kontratës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Ne hartimin e specifikimeve teknike i jemi permbajtur rekomandimit të përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit publikuar në adresën www.app.gov.al nr. 10181 prot dhe 8514 prot date 19.11.2018

Autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë që produktet ushqimore kategorizohen në :

Ushqime me origjinë shtazore

Dhe

Ushqime me origjinë joshatazore

1.1. Per produktet ushqimore të fresketa të fruta-perime të paperpunuar.

Në fletë analizat që do shoqërojnë çdo sasi të mallit të levruar, operatori ekonomik të shenojë sasinë e prodhimit që i referohet kësaj flete analize.

1.2. Per ushqimet dhe produktet ushqimore

Në vendosjen e specifikimeve teknike për këto kategori të produkteve duhet të mbahet në konsideratë që, për të gjithë produktet ushqimore do të zbatohen dispozitat e Legjislacionit për Ushqimin

Ndërmjet të tjerave, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në specifikimet teknike që:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë raport analize origjinale ose kopje të noterizuara leshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës, për produktet e ofruara.

Raport analiza perkatëse duhet të jetë sipas llojit të produktit, numrit të Lotit 2, dhe jetegjatesisë së produktit dhe të ketë lidhje me produktin/mostren e ofertuar. Në këtë raport analize duhet të jetë shënuar: emertimi i produktit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analize me produktin e ofertuar.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Produkti kur të levrohet, duhet të jetë i shoqëruar me certifikatën e origjinës dhe fletë analize për treguesit e sigurisë e cilësive, sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin.

Të gjithë treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimike të produktit të ofertuar/mostres që përfaqësojnë artikullin duhet të përputhen plotësisht me treguesit e shënuar në specifikime teknike dhe të Standardit Shtetëror përkatës. Standardet shtetërore për karakteristikat e produkteve ushqimore janë të disponueshme dhe janë të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit (DPS) në faqen e internetit *www.dps.gov.al*.

Produktet ushqimore, objekt i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1344, datë 10.10.2008 "Për miratimin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore", neni 4 dhe 13, të jenë të pajisura me etiketat respektive.

Frigoriferet e instaluar në ambientet e operatorit ekonomik të këne rregjistrat përkatës për monitorimin e temperaturës, sipas Udhezimit të Ministrit të Bujqësisë Nr. 22 datë 25.11.2010 *Per kushtet e pergjithshme e dhe te vec;anta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatoret e biznesit ushqimor*".

Automjetet e përdorur për transportin e produkteve duhet të jenë të pajisura me matës temperaturë (taograf) për gjurmimin e temperaturës gjatë levizjes të mjetit.

1.3. Produkt mishi/ i përpunuar mish.

- a. Pjesa e karkases (shpatull, kofshë dhe gjoks) duhet të jetë e vëlosur me vulën e kontrollit veterinar.
- b. çdo parti/karkase mish duhet të shoqërohet me certifikatë veterinarë, e cila garanton sigurinë e produktit "mish" dhe me të cilën vërtëtohet se, nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje, por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik.

Shtojca11

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Kuadër		Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Dokumentat Standarde të Tenderit

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi i produktit	Njësia	SASIA				Çmimi	Vlera pa TVSH
			Kopshtet	Konvikti	Çerdhja	Gjithsej		
1	Kos	Litra	5500	600	3500	9600		
2	Banane	kg	4780	300	1300	6380		
3	Vaj Ulliri	Litra	1260	100	100	1460		
4	Qumësht	Litra	14105	800	3000	17905		
5	Vezë	kokrra	37500	4000	13000	54500		
6	Djathë i bardhë lope	kg	158	700	100	958		
7	Mollë	kg	3760	450	160	4370		
8	Mish Vici	kg	1620	200	250	2070		
9	Oriz	kg	900	650	200	1750		
10	Karrota	kg	3790	80	150	4020		
11	Spinaq	kg	410	30	100	540		
12	Patate	kg	3900	400	1700	6000		
13	Limon kokërr	kg	230	80	100	410		
14	Kripë	kg	170	70	43	283		
15	Domate	kg	1490	350	80	1920		
16	Kastravec	kg	470	250	80	800		
17	Makarona	kg	780	500	250	1530		
18	Fasule	kg	630	120	100	850		
19	Mish pule	kg	1100	250	250	1600		
20	Bizele	kg	940	120	150	1210		
21	Sheqer	kg	280	100	200	580		
22	Miell	kg	550	50		600		
23	Portokall	kg	3400	300	660	4360		
24	Presh	kg	1570	40		1610		
25	Tërshërë	kg	940	0	100	1040		
26	Bukë thekre/integrale	kg	7400		1296	8696		

Dokumentat Standarde të Tenderit

27	Rigon	kg	9	5	1	15		
28	Gjizë pa kripë	kg	1400	45	100	1545		
29	Reçel kumbulle	kg	550	150	150	850		
30	Kanellë	kg	6		5	11		
31	Brokoli	kg	260		200	460		
32	Lulelakër	kg	700		200	900		
33	Kungull	kg	234		200	434		
34	Majdanoz	kg	40	5	5	50		
35	Qepë	kg	394	400	100	894		
36	Hudhër	kg	8	5	5	18		
37	Selino	kg	24		30	54		
38	Thjerrëza	kg	630	40	150	820		
39	Pluhur pjekje	kg	16	1,5	5	22,5		
40	Arrë moskat	kg	2			2		
41	Miell misri	kg	473			473		
42	Vanilje	kg	16			16		
43	Pjeshkë	kg	3213	200	660	4073		
44	Trahana	kg	315			315		
45	Bukë gruri	kg		4800		4800		
46	Sallam	kg		500		500		
47	Qofte	pako/10 copë		800		800		
48	Çaj (25 gr)	Tufë		200		200		
49	Djathë Kaçkavall	kg		90	25	115		
50	Djathë Bebe	pako		450		450		
51	Bishtaja	kg		100		100		
52	Speca	kg		100	199	299		
53	Patëllxhan	kg		70		70		
54	Vaj Luledielli	Litra		300		300		
55	Sallatë jeshile	kg		120		120		
56	Uthull (500ml)	shishe		80		80		
57	Turshi kavanoz (2kg)	kavanoz		45		45		
58	Çokokrem	kg		350		350		
59	Gjalpë	kg		150		150		
60	Kakao	kg		15		15		
61	Mandarina	kg		350		350		
62	Lakër	kg		80		80		
63	Biskota	kg		90		90		
64	Piper	pako 100gr		50		50		
65	Salcë domatesh (720 ml)	shishe		400		400		
66	Ullinj	kg		50		50		
67	Majonezë (500 gr)	kavanoz		150		150		

Dokumentat Standarde të Tenderit

68	Niseshte	kg		15		15		
69	Melçi vici	kg		30		30		
70	Salce kosi	kg		100		100		
71	Petë byreku	pako		55		55		
	Çmimi Neto							
	TVSH (%)							
	Çmimi Total							

Afatet e lëvrim: 12 muaj nga data e nënshkrimit të marreveshjes kuadër.

Shtojca 13

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|----------|-------|
| 1. _____ | _____ |
|----------|-------|

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ /Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Mallrat – Tender i Hapur**

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimit e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvuara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozite përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.

- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
